



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 67, datë 7.10.2016

**Për**

**“MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E “PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT NË NDIHMË  
TË KRIJIMIT TË BIZNESIT SOCIAL RINOR”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 6, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.9374, datë 21.04.2005 për “Ndhmën shtetërore” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58, datë 30.12.2015, për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016 (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

- 1.** Miratimin e “**Programit të Nxitjes së Punësimit në ndihmë të krijimit të Biznesit Social Rinor**” dhe zbatimin e tij sipas Udhëzuesit Operacional për zbatimin e “Programit të Nxitjes së Punësimit në ndihmë të krijimit të Biznesit Social Rinor” bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca 1.
- 2.** Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga fondi për “Programin e Nxitjes së Punësimit në ndihmë të krijimit të Biznesit Social Rinor”, parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2016.
- 3.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**